



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË MBROJTJES PËR VITIN 2021

Prishtinë, maj 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Mbrojtjes (MM), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkuara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Mbrojtjes, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Ministria e Mbrojtjes në vitin 2021 kishte kryer pagesa dhe regjistruar shpenzime në vlerë 1,129,999€ nga kategoria ekonomike joadekuate, si rezultat i planifikimit jo të duhur të buxhetit; dhe
- A2 Pasuritë ishin të nënvlerësuara për 35,386€, si pasojë e zhvlerësimit para kohe. Kjo ka ndodhur pasi që MM pesë projekte kapitale i kishte regjistruar në SIMFK si pasuri kapitale para pranimit teknik të projektit apo pa përfunduar projektin.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Mbrojtjes kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A3 A3 Pranimi i derivateve për ngrohje dhe për gjenerator në vlerë prej 145,026€ ishte bërë pa komision për pranimin e furnizimit; dhe
- A4 A4 Avanset e pambyllura në SIMFK në fund të vitit për atashetë e mbrojtjes ishin në vlerë prej 211,682€. Prej tyre 48,305€ ishin ende si avanse të hapura përkundër që atashetë e kishin përfunduar misionin e tyre në korrik/tetor 2021.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

- 1 Te Investimet Kapitale, kontratat dhe pagesat të cilat kanë qenë të klasifikuara (niveli i kufizuar) nga ana e MM-së nuk janë pjesë e këtij raporti, për faktin se ato janë audituar ndaras dhe do të përgatitet një raport i veçantë i auditimit i cili do të ju komunikohet vetëm palëve përgjegjëse.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Mbrojtjes është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Mbrojtjes.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Mbrojtjes është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Mbrojtjes në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Mbrojtjes me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Mbrojtjes.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin

transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Ministria ka shpenzuar 96% të buxhetit final ose 91,616,780€ me një përmirësim prej 5% në krahasim me vitin 2020. Fushat me probleme të theksuara të shpenzimit kanë të bëjnë me menaxhimin e financave që ndërlidhen me klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve, vonesën në mbylljen e avanseve, dhe menaxhimin e kontratave ku kishte vonesa dhe mospërbushje të kontratave përfshirë edhe pranimin e mallrave pa komision. Me tutje, pasuritë nuk ishin regjistruar siç kërkohet dhe sistemi e-Pasuria kishte gabime në përshkrime të artikujve, përfshirë edhe vonesat në raportimin nga procesi i vlerësimit dhe formimin e komisionit për tjetërsim. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm. Ky raport ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime, prej tyre gjashtë (6) janë rekomandime të reja dhe një (1) i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013-Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Shpenzimet për furnizim me municion në vlerë 1,129,999€ ishin paguar nga kategoria ekonomike e investimeve kapitale si rezultat i planifikimit jo të duhur të buxhetit edhe pse për nga natyra këto shpenzime i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime (Pagesa ishte realizuar nga kodi ekonomik 36100 - pajisje ushtarake e që do të duhej të paguhej dhe regjistrohet nga kodi ekonomik 13670 - municion dhe armë zjarri). Pagesat nga kategoritë jaadekuate mund të kenë refleksion edhe në nënvlerësimin apo mbivlerësimin e pasurive të Ministrisë.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e ndarjes së buxhetit nga Kuvendi i Kosovës të investimet kapitale, pavarësisht kërkesës së MM-së që mjetet për furnizim me municion të buxhetohen në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Ndikimi Pagesat e realizuara nga kategoria joadekuate, rezultojnë me prezantimin e gabuar të shpenzimeve në Pasqyra Financiare. Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të Ministrisë, duke mbivlerësuar/nënvlerësuar kategoritë ekonomike përkatëse, përfshirë edhe pasuritë.

Rekomandimi A1 Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV. Po ashtu, duhet të rishikohen edhe refleksionet që këto keqklasifikime kanë pasur te pasuria dhe të ndërmerren veprime për korigjimin e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Nënvlerësimi i pasurisë jo financiare

Gjetja Sipas Rregullores Financiare MF nr. 02/2013 - Për Menaxhimin e pasurisë jo financiare, në nenin 11 pikën 3 përcaktohet që pas përfundimit të procesit të investimit në vijim pasuria do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi. Kurse neni 5 i të njëjtës rregullore përcakton klasifikimin që duhet aplikuar për regjistrimin e pasurive.

Ne identifikuam se pesë (5) projekte kapitale ishin regjistruar si pasuri kapitale në përdorim në SIMFK para pranimit teknik të projektit. Si rezultat i këtij gabimi teknik kishte filluar zhvlerësimi i pasurisë dhe deri te pranimit teknik i projekteve ato veq ishin zhvlerësuar për 35,386€. Si pasojë pasuritë kapitale ishin të nënvlerësuara për këtë vlerë.

Pranimi teknik i tri projekteve ishte në dhjetor kurse zhvlerësimi kishte filluar nga muaji mars, përkatësisht gusht i vitit 2021. Përderisa pranimit teknik për dy projekte tjera ishte në gusht/tetor kurse zhvlerësimi kishte filluar nga muaji mars i vitit 2021.

Kjo kishte ndodhur për shkak të gabimeve teknike gjatë vendosjes së datës në regjistrimin e pasurive në SIMFK dhe si pasojë e kësaj kishte filluar aplikimi i zhvlerësimit të pasurisë para pranimit teknik.

Ndikimi Regjistrimi jo i duhur ndikon në raportimin jo të drejtë të vlerës së pasurive. Si rrjedhojë e këtyre mangësive kemi nënvlerësim të pasurive duke rezultuar edhe në prezantimin jo të drejtë të vlerës së tyre në pasqyra financiare.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të siguroj përmes menaxherit të financave që pasuritë janë prezantuar drejtë në PFV. Duhet shtuar kujdesi gjatë procesit të regjistrimit të pasurive dhe gabimet e evidentuara në regjistrin e pasurive duhet të korigjohen në mënyrë që vlera e prezantuar e pasurive të jetë reale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A3 - Pranimi i mallrave pa komision

Gjetja

Neni 23 i rregullës financiare nr. 01/2013 për Shpenzimin e parave publike, thekson se "Pranimi i mallit/shërbimit bëhet nga zyrtari/komisioni i autorizuar. Raporti i pranimit të mallit/shërbimit nga zyrtari/komisioni i autorizuar duhet t'i dorëzohet zyrës për buxhet dhe financa së bashku me kontratën dhe urdhërblerjen".

Ne identifikuam se në tri pagesa të furnizimeve me derivate për ngrohje dhe për gjenerator në vlerë 145,026€, pranimi i tyre ishte bërë nga një zyrtar e jo nga komisioni për pranimin e mallit/furnizimit. Sasia e furnizimeve me derivate sillej nga 500 – 12,000 litra për një furnizim (brenda një muaji kishte disa furnizime), dhe ishte në njësi (regjione) të ndryshme të Ministrisë.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos formimit të komisionit për pranimin e mallrave/furnizimeve.

Ndikimi

Pranimi i derivateve në sasi të mëdha vetëm prej një zyrtari e jo nga komisionet e pranimit, rrisin rrezikun e pranimit të furnizimeve jo sipas sasisë dhe cilësisë së kontraktuar.

Rekomandimi A3

Ministri në bashkëpunim me personat përgjegjës të Njësive të SHPFK, duhet të sigurojë që pranimet e furnizimeve me derivate për ngrohje dhe gjenerator të cilat janë në sasi të konsiderueshme të bëhen nga komisionet prej së paku tre anëtarëve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A4 - Vonesa në mbylljen të avanseve

Gjetja

Rregullorja (QRK) nr. 23/2020 për Atashetë e Mbrojtjes në nenin 19 pikën 2 përcakton që Atashetë e Mbrojtjes në çdo fund muaj përgatisin raporte të veçanta financiare për shpenzimin e buxhetit dhe i dërgojnë në Departamentin e Financave në Ministrinë e Mbrojtjes.

Në PVF ishin shpalosur avanse të pa mbyllura për atashetë e mbrojtjes në vlerë prej 211,682€. Ne analizuam tri raste të avanseve të atashetë të mbrojtjes në vlerë prej 83,185€ dhe vërejtëm që 48,305€ ishin ende si avanse të hapura (nuk ishin mbyllur në SIMFK), përkundër që atashetë e kishin përfunduar misionin e tyre gjatë vitit 2021 (në korrik dhe tetor) dhe rrjedhimisht edhe aktivitetet dhe raportimet e tyre kishin përfunduar.

Sipas zyrtarit shpenzues kjo ka ndodhur për arsye të vonesave në raportim, volumit të madh të punës përfshirë mungesën e stafit si dhe gabimeve teknike (gabimet teknike me SWIFT kodin apo tjera).

Ndikimi

Vonesat në mbylljen e avanseve edhe pas kthimit të atashetë dhe mos regjistrimi i shpenzimeve në SIMFK në kohën e duhur ndikonë në nënvlerësimin e shpenzimeve dhe mbivlerësimin e avanseve dhe rrjedhimisht edhe në pozicionet e PFV-ve.

Rekomandimi A4

Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime konkrete që raportimi i shpenzimeve nga atashetë të jenë në kohën e duhur dhe që të gjitha avanset të mbyllen bazuar në shpenzimet e ndodhura duke i respektuar afatet sipas rregulloreve në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2021 ishte 9,084,000€, prej tyre ishin shpenzuar 8,966,000€. Shpenzimet kanë të bëjnë kryesisht me ushqim dhe pije, veshmbathje për FSK-në, shkollim etj.

Çështja B1 - Vonesë në liferimin e mallit

Gjetja

Te kushtet e përgjithshme të kontratës 'Furnizim dhe Dizajnim me produkte të Marketingut për MM dhe FSK' neni 14 pika 1 ceket se "Nëse Furnizuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10% të vlerës totale të porosisë".

Ne kemi vërejtur se te pagesa në vlerë 6,940€ Ministria e Mbrojtjes kishte bërë kërkesë për furnizim me produkte marketingu (bazuar në kontratën e mësipërme), por furnizimi përveç që ishte vonuar edhe nuk ishte përmbushur nga OE në tërësi. Nga njëmbëdhjetë produkte të kërkuara vetëm gjashtë produkte ishin sjellë, (katër ishin kthyer për shkak të specifikave jo sipas kontratës). Ministria nuk kishte aplikuar penale në këtë rast.

Kjo ka ndodhur për arsye të kontroleve jo adekuate dhe faktit që menaxheri i kontratës nuk i kishte raportuar zyrës së prokurimit për këto devijime në përmbushjen e kontratës.

Ndikimi

Menaxhimi dhe monitorimi i dobët i kontratës mund të ndikojë në mos zbatimin e kontratës sipas kërkesave nga njësitë kërkuuese, rrjedhimisht në mos arritjen e objektivave dhe kërkesave të përcaktuara në kontratë.

Rekomandimi B1

Ministri duhet të sigurojë rritjen e nivelit të mbikëqyrjes dhe menaxhimit të kontratave publike, duke aplikuar penalet në rastet kur ka mospërmbushje të kontratave apo konfiskim të sigurisë së ekzekutimit. Po ashtu, duhet siguruar një kordinim më efektiv në mes akterëve rreth implementimit të kontratave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 169,849,344€, pasurive jokapitale është 1,296,980€, si dhe e stokeve 3,547,103.

Çështja A5 - Vonesa në proceset e vlerësimit dhe tjetërsimit të pasurive

Gjetja Udhëzuesi i brendshëm i datës 13.10.2020 (nr i prot.2269) për rregullat dhe procedurat e menaxhimit të pasurisë jo financiare në MM dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës në nenin 42 dhe 43 kishte përcaktuar afatet për formimin e komisioneve dhe përfundimin e raporteve të vlerësimit dhe tjetërsimit të pasurive. Ne identifikuam se:

- Komisioni për vlerësimin e pasurive e kishte përgatitur raportin dhe dorëzuar me datë 27.01.2022, përkundër që afati për raportim ishte me datë 15.01.2022, (siç e parasheh neni 42) pra me një vonesë prej 9 ditësh; dhe
- Komisioni për tjetërsimin e pasurisë ishte emëruar me datë 15.02.2022 përkundër që afati për emërim ishte me datë 20.01.2022, (siç e parasheh neni 43) pra me 17 ditë vonesë.

Arsyeja e këtyre vonesave është si rezultat i neglizhencës së akterëve të specifikuar më lartë për të kryer në kohën e duhur procesin e vlerësimit dhe tjetërsimit të pasurive.

Ndikimi Vonesat në proceset e vlerësimit dhe tjetërsimit të pasurive rrisin rrezikun që pasuria e cila ka nevojë të tjetërsohet para finalizimit të PFV-ve nuk do të mund të arrihet si rezultat i vonesave. Si pasojë regjistri i pasurive mbetet i pa azhurnuar me ndryshimet që mund të jenë të rëndësishme për prezantimin e drejtë të vlerës së pasurive.

Rekomandimi A5 Ministri duhet të siguroj se respektohen afatet e përcaktuara në lidhje me procesin e vlerësimit dhe tjetërsimit të pasurive në mënyrë që azhurnimi dhe harmonizimi i regjistrave kontabël të pasurive të kryhet para finalizimit të PFV –ve, duke reflektuar në vlerën e saktë të pasurive.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Mangësi në menaxhimin e pasurive përmes sistemit e-Pasuria**Gjetja**

Rregullorja MF nr. 02/2013 – për Menaxhimin e pasurisë jofinanciare në nenin 6 pikën 1 dhe 3 thekson se “Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Ne kemi vërejtur se në sistemin e-Pasuria artikujt ishin regjistruar me përshkrim të gabuar si në rastin kur, Kompjuterët (158 copë) ishin regjistruar si Zarf nga letra LC5. Po ashtu, në sistem figuronin 118 artikuj me përshkrimin automjete (vlera fillestare nën 1,000€) e që në realitet ishin pajisje tjera. Më tutje, në katër raste tjera kemi vërejtur se nga dy pasuri kishin barkodin e njëjtë.

Gabimet e tilla vijnë kryesisht për shkak të ndryshimeve të shpeshta të zyrtarëve ushtarak që janë përgjegjës për evidentimit e pasurisë në sistem - depo nëpër regjione dhe mungesës së trajnimeve adekuate. Po ashtu, mangësitë janë edhe si rezultat i mosfunksionimit të sistemit e-Pasuria.

Ndikimi

Mangësitë e krijuara nga përshkrimi i gabuar i artikujve dhe problemet me aplikimin e sistemit të e-Pasurisë, vështirëson menaxhimin dhe kontrollin e pasurive në dispozicion, dhe krijon konfuzion në lidhje me llojin dhe klasifikimin e pasurive brenda sistemit të e-Pasurisë.

Rekomandimi A6

Ministri duhet të siguroj që zyrtari kryesor i pasurisë brenda MM-së organizon trajnime për personelin përgjegjës që merren me regjistrim të pasurive në sistem nëpër regjione dhe duhet t'i mbaj të azhurnuar me mënyrën se si duhet aplikuar sistemi e-Pasuria.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimin e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁶	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	67,317,674	95,431,519	91,615,107	59,485,247	49,703,787
Grante Qeveritare – Buxheti	65,317,674	95,081,509	91,267,418	57,687,676	44,376,315
Te hyrat nga AKP-ja	2,000,000	0	0	1,297,581	5,327,472
Donacionet e jashtme	0	350,010	347,689	499,990	0

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 28,113,845€. Ndryshimet buxhetore kanë ardhur si rezultat i rishikimit buxhetor, vendimeve të qeverisë dhe bartjes së donacionit.

Në vitin 2021 Ministria ka shpenzuar 96% të buxhetit final ose 91,616,780€ me një përmirësim 5% në krahasim me vitin 2020. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	67,317,674	95,431,519	91,615,107	59,485,247	49,703,787
Pagat dhe mëditjet	27,371,977	25,932,188	25,930,519	25,731,853	21,973,358
Mallrat dhe shërbimet	9,024,993	9,084,115	8,196,552	8,508,797	9,450,545
Komunalitë	1,030,000	759,598	758,968	700,862	651,461
Investimet Kapitale	29,890,704	59,655,618	56,729,068	24,543,735	17,628,423

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,439,789€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i vendimit të Qeverisë nr.11/52 të datës 29.12.2021. Realizimi i buxhetit final në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve ishte 100%;


- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 59,122€. Kjo rritje ishte rezultat i vendimeve të qeverisë, rishikimit të buxhetit si dhe kursimeve buxhetore. Realizimi i buxhetit final në kategorinë mallra dhe shërbime ishte 90%;

- Buxheti final për komunalitet krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 270,402€ me vendim të Qeverisë nr.21/50 datë 23.12.2021 për kursime dhe ndarje në kategoritë e shpenzimeve në organizatat buxhetore. Realizimi i buxhetit final në kategorinë e shërbimeve komunale ishte 100%; dhe

- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 29,764,914€. Kjo rritje fillimisht ishte me vendimin e Qeverisë nr.17/19 të datës 14.07.2021 në vlerë 4,500,000€ për blerje ushtarake. Pastaj, me rishikim të buxhetit i është ndarë buxhet shtesë në vlerë 4,222,859€ për shlyerjen e obligimeve të doganës. Po ashtu, me vendim të Qeverisë nr.02/48 datë 15.12.2021 i është ndarë buxheti shtesë në vlerë 21,000,000€ për blerje ushtarake, po me të njëjtin vendim i është shkurtuar buxheti në vlerë 250,000€. Përderisa me vendim të Qeverisë nr.21/50 datë 23.12.2021 i është marrë buxheti i mbetur i pa shpenzuar në projekte kapitale për kursime buxhetore në vlerë 26,204€. Gjithashtu kemi bartje të buxhetit nga donacioni gjerman në vlerë 318,259€. Realizimi i buxhetit final në kategorinë e investimeve kapitale ishte 95%.

Në kuadër të shpenzimeve nga Grandi Qeveritar shpenzimet për menaxhimin e emergjencave për Covid-19 ishin në vlerë 6,641€ dhe ishin paguar nga mallrat dhe shërbimet. Ministria po ashtu ka pranuar donacion nga Republika Federale e Gjermanisë material mbrojtës për COVID-19 në vlerë 2,468,000 në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



3.1 Të Hyrat

Ministria në vitin 2021, nuk ka realizuar të hyra, pasi që nuk ka patur ndonjë aktivitet por që kishte një kthim dhe këto janë regjistruar si të hyra të vitit të kaluar. Arsyeja e kthimit të këtij buxheti ka rezultuar sipas Vendimeve 1/2059 datë 07 tetor 2021 dhe vendimit 1/2061 datë 7 tetor, të MM/FSK, me qëllim të kompenzimit të buxhetit të shpenzuar, me ndërprerjen e shkollimit të dy kadetëve në Akademinë Ushtarake të Turqisë.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	189,333	53,287	6,175	114,488	34,526
Të hyrat jo tatimore	189,333	53,287		114,488	34,526
Të hyrat tjera	0	0	6,175		0

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2020 të MM-së ka rezultuar me pesë (5) rekomandime. MM kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Gjithashtu, ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi Zbatimin e Rekomandimeve 30 shtator dhe 15 mars, sipas kërkesave të dala nga Rregullorja e Punës për Zbatimin e Auditimit dhe Planeve të Veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, dy (2) rekomandime janë zbatuar, dy (2) nuk janë të aplikueshëm më dhe një (1) është i përsëritur, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme për të siguruar se shërbimet e kuzhinës (racioni i ushqimit) do të shfrytëzohen vetëm nga pjesëtarët aktiv të FSK-së ashtu siç e parash Ligji e jo edhe nga stafi civil.	Ministria ka propozuar në ZKM ndryshimin e tri ligjeve bazike respektivisht Ligjin për Ministrinë e Mbrojtjes, Ligjin për FSK-në dhe Ligjin për shërbim në FSK. Në bazë të shkresës zyrtare të dt. 08.12.2021 këto Ligje janë propozuar të barten në Programin Legjislativ të Qeverisë për vitin 2022. Miratimi i rregullores së re për ushqim do të rregullohet në dispozitat e ligjeve përkatëse.	Nuk është i aplikueshëm më
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri duhet të rishikoj procedurat të cilat ndikojnë në funksionimin e kontrolleve të brendshme për të identifikuar arsyet e mos zbatimit të kërkesave të kontratës dhe të siguroj që dështimet e tilla nuk do të ndodhin në të ardhmen.	Gjatë auditimit për vitin 2021 nuk kemi identifikuar mangësi të tilla.	Nuk është adresuar
3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri duhet të hartoj aktet e veçanta nënligjore me të cilat rregullohet procedurat për monitorimin e kuzhinave në FSK në mënyrë që të evitohen keqpërdorimet e mundshme në procesin porosisë dhe marrjes së shërbimit.	ZKA ka emëruar ekipin punues për rregullimin e procedurave të brendshme lidhur me qasjen e stafit në kuzhina si dhe procedurave për monitorimin e kuzhinave të FSK-së. Ekipa punuese e ka finalizuar dokumentin dhe Ministri me datë 16.12.2021 ka miratuar rregullat dhe procedurat e brendshme lidhur me qasjen dhe monitoprimin e kuzhinave.	I zbatuar
4.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurohet që për secilin furnizim të caktohet komisioni i cili do të bëjë pranimin e mallrave sipas sasisë dhe cilësisë së kontraktuar.	Gjatë auditimit për vitin 2020 kemi identifikuar mangësi të tilla, në kategorinë e investimeve kapitale, Rekomandimi B1, mirëpo në vitin 2021 këtë dukuri e kemi hasur në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve (shih çështjen A3).	Nuk është i aplikueshëm më
5.	Investimet kapitale	Ministri duhet të identifikoj shkaktarët e mos aplikimit të kursit valutor sipas marrëveshjes dhe të siguroj kontrole adekuate në mënyrë që mangësitë e tilla të mos ndodhin në të ardhmen.	Ministria në pagesën e e fundit ka kryer barazimet me operatorin ekonomik si dhe është bërë kompenzimi i diferencave.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Ariana Berisha Rexhëbeqaj, Udhëheqëse e ekipit



Adelina Selmani, Anëtare e ekipit



Flora Berisha, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
<p>Ne identifikuam se në tri pagesa të furnizimeve me derivate për ngrohje dhe për gjenerator në vlerë 145,026€, pranimi i tyre ishte bërë nga një zyrtar e jo nga komisioni për pranimin e mallit/furnizimit. Sasia e furnizimeve me derivate sillej nga 500 – 12,000 litra për një furnizim (brenda një muaji kishte disa furnizime), dhe ishte në njësi (regjione) të ndryshme të Ministrisë.</p>	<p>ZKA në vazhdimësi në bazë të kërkesave të menaxherëve të kontratave ka formuar komisionet për pranimin e mallrave për furnizime apo shërbime për MM dhe SHPFSK. Ndërsa rasti i pranimin të derivateve në njësitë varëse të cilat janë pranuar nga një person, nuk është përgjegjësi e ZKA-së për komisione apo persona për pranime nëpër njësitë. Në njësitë varëse në FSK pranimet e mallrave/shërbimeve bëhen dhe menaxhohen sipas procedurave të brendshme. Mirëpo edhe rregullorja Nr. 01-2013, "neni 23 Pranimi i mallrave" e lejon që pranimin e mallrave apo shërbimeve mund ta bëjë Zyrtari/Komisioni i autorizuar për pranim të mallit.</p>	<p>Siç është theksuar edhe në komentin e Ministrisë, neni 23 i rregullores Nr. 01-2013, Shpenzimi i parasë publike - Pranimi i mallrave, e mundëson që pranimi i mallrave dhe shërbimeve të bëhet nga Zyrtari/Komisioni i autorizuar për pranim të mallit. Vlerësimi ynë është se pranimi i derivateve në sasi të mëdha paraqet rrezik dhe më e drejtë është të bëhet përmes komisionit të pranimin për të shmangur rrezikun e ndonjë keqpërdorimi dhe rekomandimi mbetet i pandryshuar.</p>



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada-Government
 Ministria e Mbrojtjes
 Ministarstvo Odbrane Ministry of Defense

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MBROJTJES - MINISTRY OF DEFENSE	
No Prot. / No. Protok. / No. of pages: 1196	No i Fazave / No. of pages: 1
Data / Datum / Date: 12 / 05 / 2022	
Produktimi / Issue	

DATË/A:	12.05.2022
REFERENC-Ë:	203/3/2022
PËR/ZA/TO:	Zyrën e Kombëtare të Auditimit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Armend Mehaj, Ministër i Mbrojtjes, MM
NGA/OD/FROM:	Salvador Elmazi, Zv. Sekretar i Përgjithshëm - MM
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	I etër e Konfirmimit Për pajtueshmërië me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve.



Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kemi pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Mbrojtjes, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem i pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet, duke shprehur mospajtimin me rekomandimin Nr. 3 "Pranimi i Mallrave pa komision", dhe kërkojmë që ky rekomandim të hiqet në tërësi në raportin final, duke konsideruar që Ministria e Mbrojtjes ka vepruar në pajtim me nenin 23 të Rregullës Financiare 01/2013 Shpenzimi i Parave Publike, ashtu siç edhe është dhënë komenti paraprakisht sipas shkrësës sonë të datës 06.05.2022, me nr. prot: 1136.
- Pas pranimit të Raportit final, do të perpilojmë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe duke ju përnjëzuar afate ve kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Armend MEHAJ
 Ministër i Mbrojtjes
 Datë 12.05.2022

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Raporti i pranimit teknik për projektin “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në Kazermat e FSK-së në Prishtinë dhe Gjilan” është me datë 15.12.2021 kurse zhvlerësimi është bërë nga muaji mars në regjistrin e pasurive datë e pranimit 18.02.2021. 2. Raporti i pranimit teknik për projektin “Ndërtimi i depove në Kazermat e FSK-së në Istog dhe Pomozitin” është me datë 21.12.2021 kurse zhvlerësimi është bërë nga muaji mars në regjistrin e pasurive datë e pranimit 10.02.2021. 3. Raporti i pranimit teknik për projektin “Ndërtimi i objektit të akomodimit në Kazermën e FSK-së Pomozitin” është me datë 03.08.2021 kurse zhvlerësimi është bërë nga muaji mars në regjistrin e pasurive datë e pranimit 10.02.2021. 4. Raporti i pranimit teknik për projektin “Ndërtimi i objektit të Kuzhinës në Kazermën e FSK-së Prishtinë” është me datë 28.10.2021 kurse zhvlerësimi është bërë nga muaji mars në regjistrin e pasurive datë e pranimit 18.02.2021. 5. Raporti i pranimit teknik për projektin “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe Kanalizimit në kazeremat e FSK-së Prishtinë dhe Gjilan është me datë 15.12.2021 kurse zhvlerësimi është bërë nga muaji gusht në regjistrin e pasurive datë e pranimit 07.07.2021.
- ⁵ Avanci i hapur në prill në vlerë 21,187€ nuk ishte mbyllur për 11,103€, për shkak të problemeve me transfere ndërkombëtare edhe pse Atashe kishte përfunduar misionin në tetor. Avnci i hapur në prill vlerë 39,999€ kishte mbetur i hapur për 15,203€, kurse Atashe kishte përfunduar misionin në korrik, (mbyllja është bërë me 21.03.2022). Avanci i hapur në prill vlerë 21,999€, nuk ishte mbyllur për shkak të SWIFT kodit gabim, Atashe kishte përfunduar misionin në tetor.
- ⁶ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.